



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 284/1 prot.

Tiranë, më 30.06.2021

Lënda: Përgjigje kërkesës për informacion

Av. Adriana Kalaja
Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 30.06.2021, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkesë e cila është bërë publike edhe në media, duke tërhequr edhe një herë vëmendjen për spekulimet dhe presionet e bëra kohët e fundit ndaj institucionit të Gjykatës Kushtetuese, sqarojmë se sipas nenit 12, pika 2/b, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjin nr.99/2016), Kryetari përfaqëson Gjykatën Kushtetuese në marrëdhënie me të tretët.

Në ushtrim të kësaj kompetence, Kryetari zhvillon takime me personalitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese. Dëshirojmë të theksojmë, pa asnjë ekuivok, se në asnjë prej këtyre takimeve nuk është diskutuar për çështje konkrete dhe nuk është bërë asnjë përpjekje, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, për të ndikuar në vendimmarrjen e kësaj gjykate.

Lidhur me çështjet që ju parashtroni në kërkesën tuaj për informacion, në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjme me dije se takimi me Ambasadorin Soreca ka qenë i planifikuar që më parë dhe është zhvilluar në vazhden e disa takimeve të mëparshme, të cilat kanë pasur në fokus rivënien në funksionim të Gjykatës Kushtetuese, mbështetjen e veprimtarisë së saj, si dhe zbatimin e ecurinë e reformës në drejtësi në Shqipëri.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eugen RAJANDILE

